

VENDIM
(i shkurtuar)
Nr. 2229, datë 24.6.2020

PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË FALIMENTIT

Gjykata e Shkallës së Parë e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

Neritan Cena, gjyqtar,

asistuar prej sekretares gjyqësore Besa Lleshi, sot në Tiranë, më datë 24.6.2020, përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore kërkesën që i përket:

KËRKUESE: Administratorja e falimentimit të shoqërisë “TTSGA” sh.a., znj. Shpresa Breçani, e datëlindjes 20.3.1964, me nr. personal G45320378H, e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, me licencën nr. 09, datë 16.10.2012, me NIPT K71529023 K, me adresë: rruga “Panorama” (ish-rruga “Jordan Misja”), pallati “Sara-El”, kati i dytë, celular: 0682094103.

OBJEKTI: Miratimi i raportit të administratores së falimentimit, i datës 9.3.2020, për mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “TTSGA” sh.a., shoqëri në falimentim.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 110/2016, “Për falimentimin”, VKM-ja nr. 733, datë 13.11.2019, “Për miratimin e standardeve kombëtare të administrimit të masës së falimentimit”.

Gjykata, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga ana e administratores së falimentimit të shoqërisë “TTSGA” sh.a., dëgjoi këtë të fundit në seancën gjyqësore të datës 24.6.2020, shqyrtoi edhe raportin e përgatitur nga ana e administratores së falimentimit të emëruar, “Për mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “TTSGA” sh.a., shoqëri në falimentim, dëgjoi edhe përfaqësuesit e kreditorëve të shoqërisë “TTSGA” sh.a., të cilët ishin dakord me përfundimin e procedurës së falimentimit të shoqërisë “TTSGA” sh.a., shqyrtoi edhe procesverbalin e datës 9.3.2020, të mbajtur nga ana e Komitetit të Kreditorëve të Shoqërisë “TTSGA” sh.a., shoqëri në falimentim, lidhur me mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “TTSGA” sh.a.,

VENDOSI:

- Përfundimin e procedurës së falimentimit të shoqërisë “TTSGA” sh.a.
- Urdhërohet botimi i një kopjeje të shkurtuar të këtij vendimi për përfundimin e procedurave të falimentimit të shoqërisë “TTSGA” sh.a., në faqen elektronike të Gjykatës, në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe në Fletoren Zyrtare.
- Urdhërohet administratorja e falimentimit të shoqërisë “TTSGA” sh.a., znj. Shpresa Breçani, që të depozitojë vendimin e përfundimit të procedurës së falimentimit të shoqërisë “TTSGA” sh.a. në regjistrat përkatës, me qëllim fshirjen si debitore të shoqërisë “TTSGA” sh.a. nga këta regjistra.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, afat i cili për të gjitha palët e procedurës së falimentimit dhe, konkretisht, si për Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, aksionarët e shoqërisë “TTSGA” sh.a., me përfaqësues z. Genci Germau, Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Tiranë, kreditorët e shoqërisë “TTSGA” sh.a., me përfaqësues z. Fatjon Qerimi, si dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, fillon nga data e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
- U shpall në Tiranë, sot, më datë 24.6.2020.

SEKRETAR
Besa Lleshi

GJYQTAR
Neritan Cena

Shënim. Ky vendim nuk ka marrë formë të prerë.

KANCELAR
Donald Xhelili

Tiranë, më 10.8.2020